

RELACION TEKNIK I PROJEKTIT

Rikonstrukcion i rruges Via Egnatia



TABELA E PERMBAJTJES

1. Vendodhja e rrugës	2
2. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese.....	3
3. Përshkrimi i projektit.....	4



Fig.1: Vendodhja dhe gjurma e rrugës ku do të kryhen punimet

1. Vendodhja e rrugës

Rruga “Egnatia” për të cilën propozohen punimet e ndërtimit të rrugës dhe pedonale së re ndodhet në qytetin Peqin, në veri-lindje të qendrës së qytetit, në zonat kadastrale nr. 2908 dhe 1607.

Ajo kufizohet në të gjitha anët me terren fushor dhe tokë bujqësore.

2. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese

Gjendja ekzistuese e rrugës paraqitet e paasfaltuar dhe e amortizuar (me gropa) për shkak të faktorëve të ndryshëm atmosferikë dhe kalimit të automjeteve. Gjithashtu në një pjesë të rrugës ka gjurmë të rrugës egnatia të vjetër ku shfaqen gurët në sipërfaqe. Gjithsesi duket që rruga i ka disa shtresa zhavorri dhe është mirëmbajtur herë pas here. Është rrugë lokale jashtë-qytetase me trafik të kufizuar. Gjerësia e saj është rreth 5m, dhe është e kufizuar nga të dy anët me bimësi (shkurre dhe ferra) si dhe nga një gardh metalik prone në një zonë.

Rruga gjithashtu ka edhe një urë të vjetër prej guri në zonën e saj të projektit të shek. XVII e cila është monument i mbrojtur.



Fig.2: Foto të gjendjes ekzistuese të rrugës



Fig.3: Foto të gjendjes ekzistuese të rrugës

3. Përshkrimi i projektit

Projekti i ndërtimit të rrugës dhe pedonale konsiston në ndërtimin nga fillimi me të gjitha shtresat dhe nënshtresat e parashikuara në projekt të një rruge lokale ndërqytetase, me një korsi për çdo drejtim kalimi me gjerësi prej 3m, si dhe me një korsi pedonaleje për këmbësorë në mes me gjerësi prej 3m. Në total gjerësia e rrugës së projektit është 9m.

RELACION TEKNIK I PROJEKTIT

Prej progresivit SC-01 0+000.00 deri në progresivin SC-19 0+360.00, projekti i rrugës është me gjerësi prej 9m i pandryshueshëm si në seksionin tipik në figurën mëposhtë.

Prej progresivit SC-19 0+360.00 deri në progresivin SC-21 0+400.00, projekti i rrugës propozon që rruga nga të dy krahët të devijojë e harkuar nga zona e mesit duke qenë se aty ndodhet ura antike si në figurën 5. Përveç devijimit kuotat e korsive të automjeteve janë më poshtë se ajo e urës treguar kjo në figurën 6.




Fig.4: Seksioni tipik i shtresave të rrugës së projektit




Fig.5: Propozimi i projektit në zonën e urës antike




Fig.6: Seksioni i projektit SC-20 0+380.00, në zonën e urës antike

Gjithë projekti i rrugës për zbatimin e saj është i trajtuar në:

- 1) Planimetria e rrugës;
- 2) Profili gjatësor i rrugës;
- 3) Seksione tërthore në shkallën 1:50 sipas progresivave;
- 4) Seksioni tërthor tipik në shkallën 1:20 i detajuar me shtresat e rrugës.

Planimetria e rrugës përmban aksin e saj së bashku me rakordimet e kthesave dhe progresivat çdo 20m, si në figurën 7.

Profili gjatësor i rrugës tregon vijën e terrenit ekzistues dhe propozimin e kuotave të aksit qendror të rrugës rakorduar sipas kushteve normative për një kalim sa më të qetë të automjeteve, si në figurën 8.

Seksionet tërthore në shkallën 1:50, janë shumë të rëndësishme për zbatimin e rrugës me rigorozitet pasi janë çdo 30m, ku tregojnë vijën e terrenit ekzistues me kuotat e saj, si dhe kuotat e propozuara të projektit, si në figurën 9.

Seksioni tërthor tipik në shkallën 1:20, tregon shtresat dhe nënshtresat përkatëse për realizimin e rrugës, si në figurën 4.

Për realizimin e kalimit të automjeteve do të përdoren shtresat:

- 1 – Shtresa përfundimtare prej asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm;
- 2 – Shtresë binderi me granil guri kave, 6cm;
- 3 – Shtresë stabilizanti 2x10cm, çdo shtresë e kaluar me rul për ngjeshje të mirë;
- 4 - Shtresë çakëll 10cm
- 5 – Shtresë gur gurore 30cm.

Për realizimin e pedonales do të përdoren shtresat:

- 1 – Shtresë gur kalldrëmi vendi, 8cm;
- 2 – Shtresë rëre e ngjeshur, 5cm;
- 3 – Shtresë stabilizanti e kaluar me rul, 10cm;

RELACION TEKNIK I PROJEKTIT




Fig.9: Seksion tërthor në shkallën 1:50 i projektit të rrugës

